

## J.M. - Sa vlen jeta e punëtorit?

Sunday, 07 September 2014

Sa vlen jeta e punëtorit?

J.M.

Sa vlen jeta e punëtorit?

J.M.

Sa vlen jeta e punëtorit? Me lindi kjo pyetje teksa po shihja disa foto të publikueme prej Ministrit te Mirëqënies Sociale në faqen e tij në Facebook. Ishte një album i porsavuem me titullin: “Rrugicat që kërkonin diell – Krenar për fjalën e mbajtur dhe i lumtur që qytetarët e Gjirokastrës po respektohen...”

Asht me u shqetësue se si as vetë ministrit e asnjë prej stafit të tij nuk i ban përshtypje shkelja e randë e rregullave të sigurisë në punë, aq sa bahen padashje promovues të shkeljes së të drejtës së punëtorit për sigurinë e jetës. Pashë disa foto e nxora katër prej këtij albumi dhe prej një tjetri, pa hy me i pa të gjitha shkeljet mbasi nuk ka randësi numri, por të mosqenit të ndërgjegjshëm, deri në nivelet ma të nalta, të asaj çka duhet me qenë edukata e punës dhe detyrimet e punëdhanësive ndaj të punësuesve, të cilët për me çue në shtëpi kafshaten e bukës detyrohen me punue pa kushtet minimale. Raste të tilla jo vetëm nuk bahen objekt penalizimesh, por përkundrazi jepen si shembuj të mirë deri edhe në faqen e vetë Ministrit të Mirëqënies Sociale.

Po ia filloj me foton ku vetë ministri verifikon punimet. Kushti elementar në këtë rast asht vuemja ne krye e helmetës së punës. Dikush kishte me thanë “Për krye të vet e ka!”, por jo, se veprimi i ministrit asht shembull e detyrim për të tjerët. Imagjinoni se a mundet ndonjë punëtor të nesërmen me i kërkue punëdhanësit një helmetë që kishte me i shpëtue jetën në rast ramjesh objektësh ne krye! Përgjigja kishte me qenë “Ik ore, vetë ministri hyn pa helmetë. Më shumë vlen koka jote?”.

Rasti i kësaj fotoje asht edhe ma flagrant! Një shkallë e tillë në një ambient pune, për ma tepër aq të rrezikshëm kishte me çue në ndjekje penale çdo punëdhanës, qoftë ky edhe shteti. Me mendue me hypë aty punëtorët e shkretë mes kunjave të hekurit ne beton, naltësisë, në një shkallë krejt jashtë normave e që as nuk arrin naltësinë e duhun asht papërgjegjshmëria maksimale.

Në foton e tretë një gurëgdhendës laton një element kalldremit. Ku punohet me ciflosje materiale janë të detyrueshme syzet mbrojtëse për syte, por as kjo s’i ban aspak përshtypje as ministrit e as stafit të tij. Në fund të fundit sytë janë te punëtorit e syzet kushtojnë një euro për punëdhanësin!

Fotoja e katërt, me diçiturën që lavdëron vajzat shqiptare që pranokan edhe të punojnë në industrinë e tekstileve (!), shpall me mburrje hapjen e vendeve të reja të punës. Fotoja jepet për shembull të mirë, paçka se asht në kundërshtim flagrant me rregullat ma elementare të punës në industri ku punohet me makineri. Flokët e pambledhun ne kapuç, si këto të vajzës ne foto, janë shkak i shpeshtë i aksidenteve në punë, deri edhe vdekjeprurëse, mbasi rrezikojnë të kapen prej makinës.

Këto ishin disa shembuj që dikush ka me thanë se janë vogëlsi. E di, se përballë politikave ekonomike, logjikës së fitimit, lojnave elektorale, vogëlsi asht vetë jeta e njeriut! Nji punëtor sakat, qorr apo i vdekun në punë asht vetëm nji za i statistikës!

Me që ministri mbas pak ditësh ka me takue Françeskun, po e mbylli më këtë frazë prej fjalës së papës me 18 maj 2013:

“Asht historia që tregon nji midrash biblik i nji rabinit të shekullit XII. Ai tregon historinë e ndërtimit të Kullës së Babelit e thotë se për me ndërtue Kullën e Babelit duheshin ba tullat. Çka don me thanë kjo? Me punue baltën, me prue kashten, me e krye ... e mandej në furrë. E kur tulla ishte e pjekun duhej ngjitë sipër për ndërtimin e Kullës së Babelit. Nji tullë ishte nji thesar për aq shumë punë sa duhej për me e prodhue. Kur rrëzohej nji tullë ishte tragjedi komtare e punëtori fajtor dënohej. Ishte aq e kushtueshme nji tullë sa, në se binte ishte nji dramë. Por në se binte nji punëtor nuk ndodhte asgja, ishte tjetër punë”. Ministrit të Mirëqënies Sociale i takon detyra me qenë i pari në luftë kundër kësaj logjike e me u ba garant i dinjitetit të qytetarëve në punë, qoftë edhe tue i detyrue shkelësit e rregullave e tue i edukue shqiptarët që veç i marrin problemet me gallatë, apo edhe ata që deri dje, me të drejtë ngriheshin peshë ndaj çdo shkeljeje, por sot duket se i kanë futë “veshët në lesh” para shkeljes së dinjitetit të qytetarëve!